



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 51, Datë 02.04.2024**

**MBI**

**KËRKESËN E OST SH.A., PËR INTERVALIN KOHOR 1 ORË NË OPERIMIN E  
PROCESEVE TË TREGUT BALANCUES, DHE NOMINIMEVE TË  
TRANSAKSIONEVE TREGTARE**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 02.04.2024, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 237/1 prot., datë 29.03.2024 të përgatitur nga Drejtoritë Teknike “Mbi kërkesën e OST sh.a., për intervalin kohor 1 orë në operimin e proceseve të tregut balancues, dhe nominimeve të transaksioneve tregtare”,

**Konstatoi se:**

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 106, datë 02.07.2020, vendosi miratimin e Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike.
- OST sh.a. në funksion të operimit të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike nëpërmjet shkresës së saj nr. 532 prot., datë 24. 01. 2024, parashtron në ERE si më poshtë vijon: *Në vijim të komunikimeve të deritanishme dhe ne zbatim te vendimit te ERE Nr. 110, date 27.03.2023, "Mbi kërkesën e OST sh.a., për intervalin kohor 1 ore në operimin e proceseve të tregut balancues, dhe nominimeve te transaksioneve tregtare", ku përkatësisht pika 1 shpreh si vijon: Pranimin e pjesshëm të kërkesës së OST sh.a., "Periudha kohore e proceseve ne te cilat perfshihen edhe nominimet dhe llogaritjet respektive të disbalancave të kryhet me interval kohor prej 1 ore, për periudhën 1 Prill 2023 deri në 1 Prill 2024.*
- Gjithsesi, pavarësisht implementimit në platformën e menaxhimit të tregut të OST, të intervalit kohor konform vendimit nr. 106, datë 02.07.2020 të bordit të ERE, OST sh.a. thekson se: thelbësore për të është që të operojë në harmoni me platformën e Bursës Shqiptare të Energjisë; veçanërisht në kushtet ku kooperimi i platformës së menaxhimit të tregut me platformën e Bursës Shqiptare të Energjisë është me rezolucion orar, pasi edhe Bursa Shqiptare e Energjisë

operon me bazë orare në përputhje me vendimin nr. 347, date 27.12.2022 të bordit të ERE "Mbi miratimin e Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike (rregullat e ALPEX përkufizimet, procedura e tregtimit si dhe procedura e klerimit dhe shlyerjes)".

- Me qëllim harmonizimin e dy tregjeve të energjisë elektrike, tregut të ditës në avancë dhe tregut balancues, OST sh.a. vlerëson që operimi i proceseve të tregut balancues, dhe nominimeve të transaksioneve tregtare të vazhdojë me intervalin kohor 1 orë deri në kalimin e operimit të Bursës Shqiptare të Energjisë në intervalin kohor 15 minuta.
- Për sa parashtruar nga OST sh.a. nëpërmjet shkresës protokolluar në ERE me nr. 532 prot., datë 24. 01. 2024, parashtrojmë sa më poshtë vijon:
  - Përgjatë periudhës kohore 1 Prill 2021 momenti kur ka filluar operimi i tregut të balancimit të energjisë elektrike bazuar në Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike të miratuara me vendimin e bordit të ERE-s nr. 106/2020, OST sh.a. nuk ka aplikuar rezolucionin 15 minutësh dhe në vijim të operimit të tregut të balancimit të energjisë elektrike në raportimet periodike të bëra nga OST sh.a. nuk është evidentuar problematikë në tregun e balancimit e cila të lidhet me intervalin kohor prej 1 orë në të cilin realizohen proceset ku përfshihen nominimet dhe llogaritjet respektive të disbalancave në treg.
  - Pjesëtarët e tjerë të tregut të energjisë elektrike të cilët operojnë në tregun e balancimit nuk kanë përcjellë në ERE përgjatë kësaj periudhe kohore, shqetësime apo problematika që lidhen me intervalin kohor prej 1 ore në të cilin realizohen proceset ku përfshihen nominimet dhe llogaritjet respektive të disbalancave në treg.
  - Bordi i ERE-s me vendimin nr. 108, datë 22.04.2021, ka miratuar “Rregullat e përbashkëta të shlyerjes për shkëmbimin e energjisë në përputhje me nenet 50(3) dhe 51(1), të komisionit rregullator të Bashkimit Europian 2017/2195”. Këto rregulla aplikohen nga OST-t e Evropës kontinentale anëtare të ENTSO - E, që nga data 1 Qershor 2021. Aktualisht për OST sh.a. aplikimi i këtyre rregullave është duke u realizuar me intervalin kohor prej 1 ore. Në këtë kontekst aplikimi i intervalit kohor prej 1 ore në tregun e brendshëm të balancimit të energjisë elektrike nuk sjell asnjë pasojë për këtë mekanizëm, perkundrazi aplikimi i afatit kohor prej 1 ore edhe në tregun e brendshëm të balancimit ndikon në harmonizimin e këtyre proceseve.
  - Gjithashtu vlerësimi i dhënë nga AAES e cila e konsideron si pozitiv funksionimin e tregut shqiptar të balancimit në rezolucionin 15 minutësh në qëndrueshmërinë e sistemit elektroenergjitik është një vlerësim i saktë dhe adreson në mënyrë të drejtë këtë çështje.
  - Duke qenë se jemi në kushtet ku ALPEX ka filluar operimin komercial të tregut të energjisë elektrike si dhe operimit të bashkimit të tregjeve me shumicë të energjisë elektrike, e gjerë të arsyeshme pranimin e pjesshëm të kërkesës së OST sh.a. Për periudhën deri 1 Korrik 2024 pra për një vit të operohet tregu i balancimit të Energjisë elektrike me

intervalin kohor prej 1 ore. Përgjatë kësaj periudhe kohore 3 mujore do të mund të vlerësohet ecuria dhe e operimit të tregut që operohet nga ALPEX dhe tregut të balancimit që operohet nga OST sh.a. në bashkëpunim me palët përgjegjëse për Balancim dhe ato ndërkufitare.

- Përgjatë ecurisë së operimit komercial të dy tregjeve (ALPEX sh.a. dhe OST sh.a.) do të mund të kemi një vlerësim më të plotë për një vlerësim final të harmonizimit të tregjeve ku do të vlerësohet në terma real dhe ndikimi në qëndrueshmërinë e sistemit elektroenergjitik si për operimin komercial të tregut të Energjisë elektrike që do të operohet nga ALPEX dhe tregut të balancimit, duke e vlerësuar dhe në bashkëpunim ALPEX sh.a., palët përgjegjëse për Balancim dhe ato ndërkufitare.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Pranimin e pjesëshëm të kërkesës së OST sh.a., duke vendosur: Periudha kohore e proceseve në të cilat përfshihen edhe nominimet dhe llogaritjet respektive të disbatancave të kryhen me interval kohor prej 1 ore për periudhën deri në 1 Korrik 2024.
2. OST sh.a. të raportojë çdo muaj në ERE dhe të kryej testimet përkatëse me pjesëtarët e tregut, operatorët e bursës dhe me OST-të fqinje për implementimin e intervalit kohor 15 minutësh.
3. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARE NË DETYRË**

**Erjola SADUSHI**